



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Fakulteti i Edukimit**

**Programi i studimit:  
Edukimi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç)**

*Niveli i studimeve:*  
Bachelor

*Numri i kredive:*  
240 ECTS

*Akredituar për periudhën:*  
1 Tetor 2014- 30 Shtator 2017

## **PËRMBAJTJA:**

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ..... 3
2. REZULTATET E PRITURA: ..... 4
3. PROGRAMI STUDIMOR: Edukimi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme (0 deri 3 vjeç)..... 5
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS: ..... 8

## **1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Qëllimi themelor i programit është t'i aftësojë studentët për veprimtarinë cilësore me fëmijët e moshës 0-3 vjeç. Studentët, përmes këtij programi, do të përgatiten në aspektin teorik dhe praktik në fushën e edukimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijës. Ata do të aftësohen të komunikojnë me fëmijët dhe të rriturit, duke përcaktuar në mënyrë të drejtë objektivat për të zhvilluar dhe analizuar në mënyrë kritike veprimtarinë e tyre. Lëndët e përzgjedhura në programin e studimeve për edukimin dhe zhvillimin e hershëm, u ofrojnë mundësi studentëve që të përvetësojnë njohuri profesionale dhe praktike në shumë fusha të veprimtarisë edukative në fëmijërinë e hershme. Programi, po ashtu ngërthen edhe lëndët me zgjedhje, të cilat kanë për qëllim thellimin e njohurive në fusha të caktuara edukative, duke u mbështetur në interesat individuale të studentëve. Programi i përcaktuar ka në fokus praktikën edukative, rrethanë kjo që iu krijon mundësi studentëve t'i ndërlidhin njohuritë teorike me praktikën, të transferojnë dituritë në fusha të ndryshme edukative, të cilat realizohen në veprimtarinë e institucionit.

## 2. REZULTATET E PRITURA:

- Arsimimi bazamental psikologjik, pedagogjik e sociologjik;
- Zhvillimi i kulturës së përgjithshme në fushën e gjuhës (amtare dhe angleze);
- Edukimi fizik dhe arsimimi informativ;
- Njohja, vlerësimi kritik i shfrytëzimit të teorive të zhvillimit dhe të të nxënit në fëmijërinë e hershme gjatë përcaktimit të objektivave, realizimit dhe evaluimit të veprimtarive edukative;
- Njohja dhe zhvillimi i kurrikulës për fëmijërinë e hershme;
- Njohja me metodologjinë e realizimit të kurrikulës;
- Organizimi fleksibil i mjediseve edukative për realizimin e veprimtarive të ndryshme e të llojllojshme edukative;
- Njohja me veçoritë e zhvillimit dhe të avancimit të fëmijës në të gjitha aspektet;
- Njohja dhe respektimi i nevojave, interesave individuale të secilit fëmijë, diversiteti kognitiv, social, kulturor, etj.;
- Përkujdesja e vazhdueshme për fëmijët dhe edukimi për një zhvillim të pavarësisë së tyre në harmoni me maturimin e tyre;
- Kultivimi i shprehive pozitive tek fëmijët, nxitja dhe motivimi i tyre në gjallërimin e interesave në procesin e të nxënit aktiv;
- Aftësimi në aplikimin e formave të ndryshme të ndërveprimit në komunikimin me fëmijë;
- Njohja dhe aftësimi për punë ekipore me stafin punues, shërbimet profesionale brenda dhe jashtë institucionit, etj.;

**3. PROGRAMI STUDIMOR: Edukimi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme (0 deri 3 vjeç)**

**VITI I PARË**

**SEMESTRI I**

Nr.	Lënda	Statusi	L + U	ECTS
1.	Psikologji e fëmijërisë së hershme	O	3+2	7
2.	Teoria e edukimit	O	3+1	6
3.	Kultura e të folurit	O	2+2	6
4.	Bazat e TIK	O	2+2	6
5.	Kulturë fizike	O	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>12+8</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI II**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Edukimi dhe fëmijëria e hershme	O	3+2	7
2.	Familja edukogjene	O	3+1	6
3.	Gjuhë angleze	O	3+2	7
4.	Komunikimi ndërpersonal	Z	2+1	5
5.	Psikologji e personalitetit	Z	2+1	5
6.	Zhvillimi profesional/karrierë	Z	2+1	5
7.	Sociologjia e edukimit	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+7</b>	<b>30</b>

**VITI I DYTË**

**SEMESTRI III**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor	O	3+2	7
2.	Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimi	O	3+2	7
3.	Edukimi i hershëm institucional	O	3+1	6
4.	Të drejtat e fëmijëve	Z	2+1	5
5.	Zhvillimi sensor/motorik	Z	2+1	5
6.	Lojërat skenike	Z	2+1	5
7.	Dokumentacioni pedagogjik për fëmijërinë e hershme	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+7</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI IV**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Edukimi dhe zhvillimi kognitiv në fëmijërinë e hershme	O	3+1	6
2.	Letërsia për fëmijërinë e hershme	O	3+1	6
3.	Matematika argëtuese për fëmijërinë e hershme	O	3+1	6
4.	Praktika edukative	O	2+0	2
5.	Ilustrimet-Libri i parë i fëmijës	Z	2+1	5
6.	Ushqyeshmëria në fëmijërinë e hershme	Z	2+1	5
7.	Vizatimi dhe ngjyrat në fëmijërinë e hershme	Z	2+1	5
8.	Edukimi i fëmijëve të talentuar	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>15+5</b>	<b>30</b>

**VITI I TRETË****SEMESTRI V**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Shkathtësitë e integruara gjuhësore	O	2+2	6
2.	Arti figurativ dhe kurrikulat e integruara	O	3+2	7
3.	Arti muzikor në kurrikulën e integruar	O	3+2	7
4.	Pedagogjia e mjedisit jetësor	Z	2+1	5
5.	Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës	Z	2+1	5
6.	Lojërat ritmike	Z	2+1	5
7.	Lojërat në natyre	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>12+6</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI VI**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Standardet dhe kompetencat profesionale	O	2+2	6
2.	Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm	O	2+1	5
3.	Partneriteti me familjen dhe komunitetin	O	2+1	5
4.	Praktika edukative	O	2+0	4
5.	Kukullat, dramatizimi dhe mediet	Z	2+1	5
6.	Kreativiteti në fëmijërinë e hershme	Z	2+1	5
7.	Zhvillimi socio-emocional	Z	2+1	5
8.	Çështje gjinore në fëmijërinë e hershme	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>12+6</b>	<b>30</b>

**VITI I KATËRT**  
**SEMESTRI VII**

<b>Nr.</b>	<b>Lënda</b>	<b>Statusi</b>	<b>L+U</b>	<b>ECTS</b>
1.	Strategjitë alternative në edukimin e hershëm	O	3+2	7
2.	Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i performancës	O	3+2	7
3.	Dokumentimi i zhvillimit të nxënies së fëmijës	O	2+2	6
4.	Udhëheqja e portofolios	Z	2+1	5
5.	Hulumtimi në veprim	Z	2+1	5
6.	Puna në projekte edukative	Z	2+1	5
7.	Instrumentet natyrale tradicionale	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>12+8</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI VIII**

<b>Nr.</b>	<b>Lënda</b>	<b>Statusi</b>	<b>L+U</b>	<b>ECTS</b>
1.	Bazat e hulumtimit për fëmijërinë e hershme	O	2+2	6
2.	Praktika edukative	O		12
3.	Punimi i diplomës	O		12
<b>Gjithsej</b>			<b>2</b>	<b>30</b>

#### 4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS:

<b>Përshkrimi për secilin kurs</b>	
1	<p><b>Psikologji e fëmijërisë së hershme</b></p> <p>Çështjet e trajtuara në kuadër të këtij kursi kanë për synim të plotësojnë njohuritë e studentëve me një varg çështjesh dhe problemesh të kulturës së përgjithshme dhe të asaj profesionale, sa i përket fëmijërisë së hershme. Ky kurs përshkruan në mënyrë shkencore, përmes gjetjeve empirike dhe qasjeve të ndryshme, zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës në fëmijëri të hershme dhe proceset e vazhdueshme të funksionimit psikologjik të fëmijës.</p>
2	<p><b>Teoria e edukimit</b></p> <p>Kursi trajton konceptet themelore pedagogjike, pedagogjinë si shkencë, teorinë dhe modelet e procesit të edukimit, influencën e teorisë së edukimit dhe praktikën pedagogjike, përmbajtjet, format, dhe metodat e edukimit, gjithashtu trajtohet edukimi si proces (aspekti individual) dhe edukimi si fenomen (aspekti interaktiv), detyrat edukative me theks të veçantë, edukimi intelektual dhe moral, roli dhe rëndësia e njohurive profesionale, kualifikimi pedagogjik dhe përgatitja e edukatorëve rreth të nxënësve gjatë gjithë jetës.</p>
3	<p><b>Kultura e të folurit</b></p> <p>Përmes mësimin të këtij kursi, në formë të ligjëratave dhe të ushtrimeve, studentët do t'i gjejnë njohuritë e tyre paraprake në lidhje me: ligjërimin; funksionet nyjetimit jehësor; gjuhën e folur dhe gjuhën e shkruar (karakterit dhe natyra e shprehjes); diasistemin e gjuhës dhe gjuhën letrare; ndarjen dialektore të gjuhës shqipe (në mbështetje të veçorive gjuhësore); gjuhën e sotme letrare shqipe. Do të trajtohen nocionet e përgjithshme dhe përfshirja e emërtimeve; aspekte të ndryshme të kulturës së të folurit (aspekti gjuhësor, shoqëror dhe estetik), fonetika dhe fonologjia, fjala si element - njësi leksiko- gramatikore, aspektet sintaksore dhe stilet gjuhësore të kulturës së folur.</p>
4	<p><b>Bazat e TIK</b></p> <p>Kursi do të trajtojë: gjeneratat e kompjuterëve, sistemin kompjuterik, sistemet operative. Windows, programet aplikative, informacionet dhe komunikimet.</p>
5	<p><b>Kulturë fizike</b></p> <p>Do të shqyrtohen çështje si: shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve si faktor kyç në procesin e rritjes dhe zhvillimit që bëhet gjatë periudhës së hershme të jetës; rritja dhe zhvillimi të fëmijës si proces paralel dhe komplementar; ndryshimet që ndodhin në shkallën e kompleksit në kryerjen e funksioneve të caktuara dhe në fitimin e shkathtësive të caktuara; mbajtja e drejtpeshimit, kontrolli në pjesët e trupit, si dhe</p>



	forcimi e koordinimi psiko-motorik.
6	<p><b>Edukimi dhe fëmijëria e hershme</b></p> <p>Kursi në përmbajtjen e vet ngërthen njohuri, dituri dhe shkathtësi për procesin e edukimit dhe karakteristikat e zhvillimit të fëmijës. Këtu do përfshihet gjithashtu filozofia dhe parimet e edukimit në fëmijërinë e hershme, faktorët e edukimit dhe ndërveprimi aktiv i tyre, strukturimi i mjedisit jetësor dhe përvoja e fëmijës, ndërveprimi aktiv i fëmijës në relacion me të rriturit dhe bashkëmoshatarët, individualiteti në fëmijërinë e hershme dhe edukimi në kontekst jetësor, format, mjetet dhe metodat aktive në realizimin e veprimtarive edukative, roli i të rriturve në procesin e edukimit në fëmijërinë e hershme, etj.</p>
7	<p><b>Familja edukogjene</b></p> <p>Ky kurs përfshin njohjen e nocioneve themelore përkitazi me familjen edukogjene; njohuritë për proceset, funksionet bazike familjare dhe ndikimin e tyre në edukimin e hershëm; tipologjitë e familjeve ekzistuese, veçanërisht ndër ne, prindërit, tipat e prindërve dhe stilet e edukimit në fëmijërinë e hershme, raportet bashkëshortore e ato prindërore dhe midis fëmijëve, gjithnjë në korrelacion me edukimin në fëmijërinë e hershme; aspektet e edukimit familjar në fëmijërinë e hershme, instrumentari pedagogjik familjar, human e demokratik dhe aplikimi në EHF; rekomandimet për pedagogjizimin e mjedisit familjar, për ngritjen e kulturës psiko – pedagogjike të prindërve dhe partneriteti cilësor me mjediset e tjera sociale dhe institucionet parashkollore.</p>
8	<p><b>Gjuhë angleze</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre të zotërimit të gjuhës angleze në njërën anë, ndërsa në anën tjetër, kjo lëndë u ofron studentëve mundësi të zhvillimit të shkathtësive të punës me fëmijë të nivelit parashkollor. Ky kurs u ofron studentëve mundësi të zgjerimit të njohurive për aktivitetet e ndryshme që mund të realizohen në nivelin parashkollor duke përfshirë fotografi të ndryshme, aktivitete me ngjyra e lojëra.</p>
9	<p><b>Komunikimi ndërpersonal</b></p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohet dinamika e komunikimit interpersonal në mes të subjekteve në mjediset edukative në rrethana institucionale, (në veçanti në mes të fëmijëve dhe edukatorëve, moshatarëve, stafit të shkollës, prindit me personelin mësimor etj.). Do të fillohet nga këndvështrimi mbi çështjet parimore dhe shkathtësitë e nevojshme për komunikim të efektshëm interpersonal, pastaj të vazhdohet me komunikimin nga pikënisja personale, (vetkoncepti dhe të tjerët) që pastaj të përfundohet me çështje më komplekse rreth dinamikës së komunikimit interpersonal në klimën e realizimit të procesit edukativ arsimor, në rrethanat</p>

	institucionale.
10	<p><b>Psikologji e personalitetit</b></p> <p>Kursi ofron njohuri të përgjithshme mbi zhvillimin e personalitetit të edukatorit dhe të fëmijës. Kursi shtjellon në detaje teoritë e ndryshme për zhvillimin e personalitetit, stadet në teoritë zhvillimore, hulumtimet kryesore në fushën e personalitetit dhe ndikimet kryesore në zhvillimin e personalitetit; tiparet themelore të personalitetit, vlerat, besimet dhe ndikimet e trashëgimisë dhe edukimit, shtjellon njohuri të përgjithshme për çrregullimet më të shpeshta të personalitetit dhe ndikimin që këto çrregullime kanë në individin, familjen dhe shoqërinë në përgjithësi.</p>
11	<p><b>Zhvillimi profesional/karrierë</b></p> <p>Orientimi për karrierë dhe zhvillimi profesional, është një kurs, që është përherë aktual, dhe për t'iu ofruar fëmijëve të kësaj moshe informacione të nevojshme për profesionet e ardhmërisë, përkatësisht për zhvillim dhe orientim në karrierë, mbase do të duhej të informohen, si prindërit e fëmijëve, ashtu edhe edukatorët dhe institucionet tjera shoqërore arsimore e shkencore.</p>
12	<p><b>Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që të përgatiten me njohuritë rreth rëndësisë së bashkëpunimit me institucionin parashkollor, si dhe me zbatimin e këtyre njohurive në praktikë. Do të njihen me lojërat lëvizore jo vetëm në aspektin e edukimit të shprehive lëvizore të subjekteve, por edhe në një aspekt tjetër më të gjerë, në atë të edukimit të tipareve të karakterit e të personalitetit. Parashikohen dhe janë vendosur një volum i madh veprimesh fiziko-lëvizore, në formën e veprimeve të thjeshta, por edhe komplekse, të gjitha këto në përshtatje me kategoritë e moshave parashkollore, shkollore të subjekteve e më gjerë, ku vendin më të rëndësishëm e kanë zënë lojërat lëvizore.</p>
13	<p><b>Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimi</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që të përgatiten me njohjen e proceseve të veçanta të zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit për mosha të vogla, gjithashtu të identifikojnë modelet e krijimit për këtë grupmoshë. Ky kurs përkufizon komunikimin dhe zhvillimin e gjuhës duke u nisur mbi disa parametra praktikë të fëmijërisë së hershme, siç janë: akti i komunikimit, llojet e komunikimit, funksionet e gjuhës, rregullat e komunikimit, koherenca, teksti gjuhësor, subjekti folës, etj. Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me shumë faktorë që e bëjnë këtë kurs të përshtatshme me të menduarit konkret dhe ende të pazhvilluar të fëmijës, si dhe me subjektin e thjeshtë të gjuhës.</p>
14	<b>Edukimi i hershëm institucional</b>

	<p>Kursi në përmbajtjen e vet programore do të ofrojë dituri dhe shkathtësi lidhur me rolin e edukimit të hershëm institucional, funksionin edukativ të institucionit edukativo- arsimor në periudhën e fëmijërisë së hershme, shpjegimin e nocioneve bazë lidhur me edukimin në përgjithësi dhe edukimin e institucionalizuar në veçanti, specifikat dhe veçantitë dalluese të edukimit të hershëm institucional, dinamikat dhe konteksti i edukimit të institucionalizuar në fëmijërinë e hershme; procesin e adaptimit të fëmijës për jetën në institucionin edukativ; planifikimin e kujdesit dhe punës edukative në institucionin edukativ.</p>
15	<p><b>Të drejtat e fëmijëve</b></p> <p>Ky kurs trajton parimet udhërrëfyese të të drejtave njerëzore të fëmijës. Aspirata për të mbrojtur identitetin dhe dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore, pa përjashtuar fëmijët, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë mirëqenien e fëmijës në qendër të interesit, vëmendjes dhe përkushtimit tonë. Si e tillë, ajo bazohet në kornizën, e cila ndërthet sistemin e vlerave të përbashkëta universale të mbrojtura përmes standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, e njohur si Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Ky kurs kërkon të përgatisë studentët të formulojnë pyetje dhe argumentojnë përgjigje sa i përket çështjes së të drejtave të fëmijëve e të rinjve me të cilat janë përballur vetë ose mund të përballen gjatë përvojës së tyre jetësore, duke i analizuar ato në raport me realitetet ekzistuese.</p>
16	<p><b>Lojërat skenike</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi, që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike, të përgatiten me njohuri që paraqesin rëndësinë e bashkëpunimit të studentit dhe fëmijëve, si dhe për zbatimin e këtyre në praktikë. Përveç kësaj, ata do të njihen me përdorimin e ngjyrave dhe tonalitetet të shumta. Përmes këtij kursi gjithashtu synojmë një lëvizje progresive në ngritjen e cilësisë dhe avancimin tek mësimdhënësit e ardhshëm, për të parë rëndësinë e punës profesionale.</p>
17	<p><b>Dokumentacioni pedagogjik për fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që në arrijnë të kuptojnë rëndësinë e dokumentimit të zhvillimit dhe nxënies së fëmijëve gjatë periudhës së hershme dhe gjatë edukimit të tyre të institucionalizuar. Aplikimi në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike e të gjitha aktiviteteve dhe punës së fëmijëve, do t'u mundësojë studentëve që të përvetësojnë mënyrën e përgatitjes së portofolios së fëmijës, duke filluar që nga mosha e tyre e hershme 0-3 vjeç. Ata do të shkathtësohen në aspektin profesional, për të përcjellë në mënyrë të vazhdueshme punën e fëmijëve. Synohet një lëvizje progresive në ngritjen e cilësisë dhe avancimin, tek mësimdhënësit e ardhshëm, për të parë dokumentimin e zhvillimit dhe punës së fëmijëve.</p>
18	<p><b>Edukimi dhe zhvillimi kognitiv në fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Përmbajtja e këtij kursi mundëson që studentët të përvetësojnë konceptet,</p>

	<p>përmbajtjet dhe teoritë bazë që lidhen me njohjen dhe zhvillimin e njohjes (kognicionit) tek fëmijët që nga mosha e hershme, menjëherë pas lindjes. Do të kenë mundësinë e njohjes me perspektivat në fushën e psikologjisë kognitive dhe zhvillimit të fëmijëve në vend dhe më gjerë, dhe të kuptojnë psikologjinë kognitive si studimi i rrugëve dhe përpjekjeve për zhvillimin e të menduarit në përgjithësi.</p>
19	<p><b>Letërsia për fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që të përgatiten me njohjen e proceseve të veçanta letraro-artistike për mosha të vogla dhe të identifikojnë modelet e krijimit për këtë grupmoshë. Ky kurs përkufizon gjininë, llojin dhe zhanrin më konceptual dhe praktik për fëmijërinë e hershme, siç është përralla dhe llojet e saj, këngët popullore për fëmijë, ninullat, gjëgjëzat popullore dhe të kultivuara etj. Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me shumë faktorë që e bëjnë këtë letërsi të përshtatshme me të menduarit konkret dhe ende të pazhvilluar të fëmijës, si dhe me subjektin e thjeshtë të kësaj krijimtari letrare, që zhvillohet në vijë të drejtë dhe pa gërshetime ngjarjesh e vijash paralele.</p>
20	<p><b>Matematika argëtuese për fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Në këtë kurs studentët, duke u bazuar në kurrikulë, do të marrin informacione lidhur me zhvillimin dhe planifikimin e aktiviteteve fillestare zbatimëse matematikore, lidhur me numrat dhe numërimin, figurat themelore gjeometrike, hapësirën dhe matjet, krahasimin e madhësive si dhe integrimin e edukimit matematikor me fushat tjera, etj.</p>
21	<p><b>Praktika edukative</b></p> <p>Përmes praktikës edukative studentet do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve. Përmes <i>Doracakut të Mësimit Praktik</i> studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës edukative.</p>
22	<p><b>Ilustrimet-Libri i parë i fëmijës</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që të përgatiten me njohjen e proceseve të veçanta ilustrativo-artistike të librit për fëmijërinë e hershme dhe të identifikojnë modelet e krijimit për moshën 0-3. Përmes këtij kursi studentët do të shfrytëzojnë njohuri themelore, si: logjika artistike, imagjinata, zhvillimi i inteligjencës, shprehja figurative përmes ilustrimit, dekorimit, komunikimi përmes figurave, simbolet e vijave dhe formave. Njihen me shumë teknika që e bëjnë ilustrimin e librit të përshtatshëm me të menduarit konkret në procesin e zhvillimit të fëmijës.</p>
23	<p><b>Edukimi i fëmijëve të talentuar</b></p> <p>Kursi shtjellon çështje lidhur me identifikimin me kohë të fëmijëve të talentuar, njohjen me format, metodat dhe strategjitë e reja të punës me fëmijët e talentuar si</p>

	dhe akcelerimin e tyre brenda dhe jashtë institucioneve parashkollore. Analiza e hulumtimeve bashkëkohore për nxënësit e talentuar trajton mundësitë e përshtatshmërisë së programeve mësimore dhe aktiviteteve tjera arsimore për nivelet e kategorive të fëmijëve të talentuar.
24	<p><b>Shkathhtësitë e integruara gjuhësore</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që të përgatiten me njohjen e shkathhtësive të integruara gjuhësore për grupmoshat më të vogla. Ky kurs përkufizon zhvillimin e gjuhës, jo vetëm brenda saj, por edhe të integruar me përbërës të tjerë të komunikimit përmes saj si: gjuha dhe mjetet e komunikimit, informacioni dhe komunikimi, gjuha në veprim (në afërsi dhe në largësi), të komunikuarit me ndërveprim, shoqëria dhe gjuha e komunikimit, gjuha dhe shoqëria, gjuha dhe përdorimi i saj me gjuhët e tjera, gjuha dhe stilet profesionale të përdorimit të saj etj.</p>
25	<p><b>Arti figurativ dhe kurrikula e integruara</b></p> <p>Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuri themelore, si: logjika artistike, imagjinata, zhvillimi i inteligjencës, shprehja figurative përmes vizatimit, pikturimit, modelimit, komunikimi përmes figurave, simbolet e vijave dhe ngjyrave.</p>
27	<p><b>Arti muzikor dhe kurrikula e integruara</b></p> <p>Ky kurs përfshinë disa metoda dhe strategji bazike të mësimdhënies së muzikës në fëmijërinë e hershme (0-3) Kursi ofron njohuri dhe shkathhtësi për realizimin e komponenteve të edukimit muzikor që parashihen në programin mësimor (Krrikulën e edukimit parashkollor dhe standardet e zhvillimit në fëmijërinë e hershme). Poashtu përfshihen edhe aspekte teorike të metodologjisë së mësimdhënies muzikore dhe aplikimi i tyre në praktikë</p>
28	<p><b>Pedagogjia e mjedisit jetësor</b></p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: 1. Njohja me konceptet e përgjithshme të mjedisit: ekologjia dhe faktorët ekologjikë, mjedisi si nocion, ndotja, ndotësi, rrugët e futjes, interaksionet dhe pasojat; 2. Substratet kryesore mjedisore: ajri, uji, toka dhe biodiversiteti dhe ndërlidhja mes tyre; 3. Edukimi mbi aktivitetet kryesore zhvillimore të njeriut me ndikim në mjedisin jetësor si: energjia, transporti, industria, bujqësia, turizmi etj.; 4. Presionet kryesore në mjedisin tonë: mbeturinat, zhurma, urbanizmi dhe kimikatet; 5. Zhvillimet globale mjedisore: ndryshimet klimatike, hollimi i shtresës së ozonit, acidifikimi dhe ndotja e deteve e oqeanëve; 6. Edukimi mbi masat globale, evropiane dhe nacionale për mbrojtjen e mjedisit: konventat, protokollet, strategjitë dhe planet si dhe qasja individuale ndaj problemeve mjedisore; 7. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm.</p>

29	<p><b>Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës</b></p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me rëndësinë e Kurrikulës në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve në punën e tyre të përditshme. Do të kenë mundësi që të analizojnë dhe zbërthejnë në praktikë Kurrikulën e edukimit parashkollor, niveli 0-3 vjeç. Gjithashtu kursi ofron orjentimin e edukatoreve për të trajtuar dokumentin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulën Bërthamë të këtij niveli.</p> <p>Studentët do të përfitojnë njohuri teorike dhe praktike për planifikimin e aktiviteteve bazuar në kompetenca, ReN, duke bërë integrimin ndërfaqshor në aktivitetet e tyre. Kursi do të trajtojë edhe format e vlerësimit të kompetencave sipas shkallës.</p>
30	<p><b>Lojërat ritmike</b></p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me me lojërat ritmike fëmijërore përfshirë këtu lojërat funksionale, lojërat e fantazisë, lojërat receptive, lojërat kreative si dhe lojërat didaktike muzikore .Dramatizimin e lojërave muzikore dhe inskenimi i tyre. Duke vazhduar me dëgjimet muzikore të përshtatura për moshën adekuate. Përmes dëgjimit dhe interpretimit muzikor të krijojmë koreografi të ndryshme.</p>
31	<p><b>Standardet dhe kompetencat profesionale</b></p> <p>Nga kursi, standardet dhe kompetencat profesionale studentët do të kenë mundësi të përvetësojnë konceptet, përmbajtjet dhe teoritë bazë lidhur me etikën e punës dhe kodin etik, me njohjen e specifikave të profesioneve të veçanta dhe të drejtat e fëmijës. Do të kenë mundësinë të përvetësojnë përvoja teorike dhe praktike të standardeve dhe kompetencave bazë të punës me fëmijët e moshave të hershme. Do të trajtohet njohja e perspektivave në fushën e etikës dhe normave morale dhe me filozofia e implementimit të tyre.</p>
32	<p><b>Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm</b></p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi të thellojnë njohuritë përkitazi me arsimin gjithëpërfshirës, në përgjithësi dhe gjithëpërfshirjen në fëmijërinë e hershme, në veçanti. Do të studiohet zhvillimi i shkathtësive të interpretimit dhe vlerësimit të teorive dhe praktikave për gjithëpërfshirjen nga perspektiva ndërkombëtare dhe ajo kosovare. Do të trajtohet aplikimi i formave të ndryshme të gjithëpërfshirjes në fëmijërinë e hershme, që ndërlidhen me respektimin e secilit fëmijë pa marrë parasysh gjuhën që flasin, kombin, fenë apo diversitetet e çfarëdo natyre. Studentët do të njihen me aplikimin e strategjive të mësimdhënies gjithëpërfshirëse që bëjnë të mundur përfshirjen aktive të të gjithë fëmijëve në aktivitete edukative e rekreative konform potencialeve fizike, psikike e emocionale të moshës së fëmijërisë së hershme.</p>

33	<p><b>Partneriteti me familjen dhe komunitetin</b></p> <p>Filozofia tradicionale dhe filozofia e avancuar e partneritetit të institucionit parashkollor me familje dhe komunitetin, qëllimet, objektivat dhe rëndësia e partneritetit për zhvillimin dhe edukimin në fëmijëri të hershme; procesi i partneritetit në fushën e shëndetit dhe fizikut, fushën socio – emocionale, mendore etj.; faktorët partnerialë primarë dhe stilet e partneritetit, ekologjia dhe klima e partneritetit, parimet, metodat dhe format e partneritetit efektiv për zhvillim dhe edukim të hershëm të fëmijës.</p>
34	<p><b>Praktika edukative III</b></p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: specifikat e planifikimit të punës edukative në fëmijërinë e hershme, planifikimi i kurrikulumeve të ndërlidhura, vlerësimi në fëmijërinë e hershme, përgatitja e mjeteve mësimore, duke përdorur materialet ricikluese dhe materiale tjera, të cilat janë në dispozicion.</p>
35	<p><b>Kukullat, dramatizimi dhe mediet</b></p> <p>Në këtë kurs do trajtohet zhvillimi i aftësive tek fëmijët dhe plotësimi i kërkesave të tyre për t'u lozur rrolli i artistit-kukull në përputhje me moshën 0-3 vjeç pa kufizim gjinie, gjithashtu do të bëhet njohja me personazhet, skenografinë, stilistikën, dritën, hijen dhe zërin. Përmbajtja, ngjarja apo veprimi konkret duhet të konstatohen dhe pasqyrohen në parim pa paragjykime dhe emocione. Por, pikërisht këtu qëndron dhe rreziku i manipulimit. Mediet konstruktojnë ngjarjet, të cilat nuk kanë ndodhur në të vërtetë, vetëm e vetëm për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik e në veçanti të të vegjëleve, duke u nisur nga kinokukullat, filmat vizatimorë, që shpesh shërbejnë si imazh manipulues apo gjykues për publikun. Përmes kësaj lënde gjithashtu synojmë një lëvizje progresive në ngritjen e cilësisë dhe avancimin tek mësimdhënësit e ardhshëm për të parë vlerën dhe rëndësinë e partneritetit në punën e tyre profesionale.</p>
36	<p><b>Kreativiteti në fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Gjatë kursit do të fokusohen çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e procesit të punës kreative me fëmijët parashkollorë. Fillimisht jepet një pasqyrë rreth teorive të ndryshme që paraqesin bindje dhe qëndrime rreth sigurimit të eksperiencave kreative në fushat e ndryshme të artit e të punës me këtë kategori të fëmijëve. Në vazhdim do të trajtohen nevojat, veçantitë dhe përfitimet nga një qasje e tillë edukative, si dhe njëkohësisht do të mendohen e analizohen modelet e mësimit për këta fëmijë, në varësi me synimet e një kurrikule të integruar në përgjithësi, si dhe nga karakteristikat e zhvillimit, nevoja dhe interesat e secilit fëmijë në veçanti. Me rëndësi të veçantë është dhe planifikimi, rregullimi, dhe menaxhimi i ambientit</p>

	<p>kreativ në klasë, materialet dhe burimet, si dhe vlerësimi i shprehjes kreative të fëmijëve të kësaj moshe.</p>
37	<p><b>Zhvillimi socio-emocional</b></p> <p>Në përgjithësi kursi tenton të qartësojë nocionet e ndjenjave dhe reagimet afektive të fëmijës në periudhën e fëmijërisë së hershme, dhe reaksionet e ndërveprimet e para sociale të fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku jeton; ndikimin e këtyre të fundit në zhvillimin psiko-social të tij. Studentët do të aftësohen për të kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit; do të trajtohet rëndësia e njohjes së emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të fëmijës që nga foshnjëria e tutje, dhe si të kujdesemi për fëmijët që mos të krijojmë vështirësi emocionale dhe sociale në zhvillimin e tyre.</p>
38	<p><b>Çështje gjinore në fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Kursi përfshin konceptet themelore që kanë të bëjnë me çështjet gjinore. Përveç kësaj, ky kurs paraqet teorinë e zhvillimit të identitetit dhe rolit gjinor (teoria psiko-dinamike e Frojdit, teoria konjitive dhe teoria e të mësuarit social). Gjithashtu, kursi ofron njohuri edhe për aspektin antropologjik, sociologjik dhe psikologjik të nocionit të rolit gjinor. Roli i faktorëve shoqërorizues në zhvillimin e identitetit të fëmijës është pjesë përbërëse shumë e rëndësishme e këtij kursi.</p>
39	<p><b>Strategjitë alternative në edukimin e hershëm</b></p> <p>Kursi në përmbajtjen e vet ngërthen njohuri teorike dhe shkathtësi praktike të përvojave edukative të aplikuara në praktikat pozitive edukative. Do të trajtohet shpjegimi dhe reflektimi i teorive të të nxënësve në fëmijërinë e hershme; qasja në procesin e edukimit në grupmoshat deri në tre vjeç dhe strategjitë e edukimit; llojet e edukimit alternativ dhe respektimi i individualitetit; filozofia e strategjive edukative në fëmijërinë e hershme; përparësitë e strategjive edukative dhe aplikimi i tyre në kontekstin jetësor; roli i edukatores në aplikimin e strategjive alternative në procesin e edukimit të hershëm, etj.</p>
40	<p><b>Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i performancës</b></p> <p>Në këtë kurs shqyrtohen njohuritë për vlerësimin si faktor i rëndësishëm në avancimin profesional të edukatorëve, zbatimin e teknikave dhe instrumenteve vlerësuese si dhe vetëvlerësimi i performancës së edukatorëve në institucione parashkollore. Kursi përfshin kriteret e performancës si: cilësia, komunikimi, shkathtësitë, iniciativa, kreativiteti etj., metodat e vlerësimit dhe problemet e vlerësimit të performancës.</p>
41	<p><b>Dokumentimi i zhvillimit të nxënies së fëmijës</b></p>



	<p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: Rëndësia e dokumentimit të zhvillimit dhe nxënies së fëmijës gjatë periudhës së hershme. Aplikimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike, i të gjitha aktiviteteve dhe punës së fëmijëve, do t'u mundësojë studentëve që të përvetësojnë mënyrën e përgatitjes së portofolios së fëmijës, duke filluar që nga mosha e tyre e hershme 0-3 vjeç. Shkathtësimi i studentëve në aspektin profesional, për të përcjellë në mënyrë të vazhdueshme punën e fëmijëve, në zhvillimin e tyre fizik, emocional, intelektual etj. Ngritja e cilësisë dhe avancimi i mësimdhënësit të ardhshëm për të parë dokumentimin e zhvillimit dhe punës së fëmijëve, dhe lehtësimi i punës së tyre, për të bërë planifikime dhe aktivitete, në përputhje me njohjen dhe zhvillimin e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç.</p>
42	<p><b>Udhëheqja e portofolios</b></p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: Rëndësia e dokumentimit të zhvillimit të tyre profesional gjatë katër viteve të studimit. Krijimi i kulturës së dokumentimit të njohurive dhe të çdo punë që ata do ta bëjnë, qoftë në fakultet apo institucionin, ku do të mbajnë praktikën pedagogjike. Njëkohësisht studentët do të vetëdijësohen për rritjen e tyre profesionale, duke i grumbulluar të gjitha të dhënat e punës dhe aktiviteteve të tyre, gjatë katër viteve të studimit, në një portofolio të tyre personale, e cila do t'ju ndihmojë në përgatitjen e punimit të diplomës në semestrin e tetë.</p>
43	<p><b>Hulumtimi në veprim</b></p> <p>Në këtë kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim, mënyrat e identifikimit të problemeve dhe hapat e implementimit të hulumtimit në institucionet dhe mjediset edukative të fëmijëve 0-3 vjeç. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave, të qëllimeve të hulumtimit në veprim, bazën teorike, proceset dhe çështjet e përfshira në 'ciklet' e realizimit të një hulumtimi në veprim, si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces vetë-reflektues. Po ashtu, kursi do të shërbejë si një burim për hulumtimet e mëtutjeshme në fushën e edukimit dhe zhvillimit në fëmijërinë e hershme.</p>
44	<p><b>Puna në projekte edukative</b></p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësi që në arrijnë të kuptojnë rëndësinë e punës me projekte. Gjithashtu do të arrijnë të njihen drejtpërdrejtë me mënyrat e punës me projekte edukative, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e fëmijës që në moshën e hershme 0-3 vjeç. Studentët gjatë kësaj periudhe do të angazhohen në planifikimin e projekteve edukative duke e planifikuar në detaje zhvillimin e projekteve. Gjithashtu, studentët duhet të bëjnë përshtatjen e projekteve edukative me nevojat dhe zhvillimin e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç dhe organizimin e projekteve.</p>

45	<p><b>Instrumentet natyrale tradicionale</b></p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me Instrumentet ritmike të Orffit, mundësitë teknike, pjesët e tyre si dhe mënyra e interpretimit. Instrumentet melodike mundësitë teknike të tyre si dhe mënyra e interpretimit. Ushtrime praktike për luajtjen në instrumentet ritmike dhe melodike të orffit si dhe shoqërimi i këngëve të ndryshme me specifika të grupmoshës së të vegjëlve përkatësisht 0-3 vjeç.</p>
41	<p><b>Bazat e hulumtimit për fëmijërinë e hershme</b></p> <p>Nga kursi, <i>bazat e hulumtimit për fëmijërinë e hershme</i>, studentët do të kenë mundësi të përvetësojnë konceptet, përmbajtjet dhe qasjet metodologjike të hulumtimeve për moshat e hershme të fëmijëve. Studentët do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike lidhur me metodat dhe teknikat e hulumtimit të zhvillimit filogjenetik dhe ontogjenetik të fëmijëve. Do të kenë mundësinë e fitimit të njohurive lidhur me perspektivat në fushën e metodologjisë për hulumtim të fëmijëve që nga moshat më të hershme dhe të kuptojnë rrugët e perspektivat që ndiqen tek ne dhe në botë.</p>
42	<p><b>Praktika edukative IV</b></p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i punës edukative sipas karakteristikave të moshës në fëmijërinë e hershme, si dhe veçantive të programit me të cilin punohet. Do të punohet më konkretisht në plane individuale për zhvillimin e fëmijëve në varshmëri me nevojat, potencialin zhvillimor të tyre, por edhe në vlerësimin e zhvillimit të fëmijëve në dimensione të ndryshme, do të diskutohet përgatitja e mjeteve mësimore, strategjitë interaktive për grupe të vogla, bashkëpunimi me stafin profesional në institucionin parashkollor, me familjen dhe komunitetin. Ndërkohë, studentët vetëvlerësojnë ngritjen e tyre profesionale.</p>
43	<p><b>Punimi i diplomës</b></p> <p>Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor.</p>